



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 543 Prot.

Tiranë, më 13.9.2024

V E N D I M

Nr.50, datë 13.9.2024

***PËR FILLIMIN E MBIKËQYRJES SË ORIENTUAR PËR MBLEDHJEN E
INFORMACIONIT LIDHUR ME REALIZIMIN NË KOHË TË TRAJNIMEVE TË
DETYRUESHME DHE TRAJNIME TË TJERA QË SYNOJNË RRIJTJEN
PROFESIONALE TË NËPUNËSVE CIVILË NË ADMINISTATËN PUBLIKE***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, bazuar në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, VKM nr.1037, datë 16.12.2015, “Për procedurat e vlerësimit të nëpunësve civilë për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë”, si dhe në Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të ndryshuar të Komisionerit,

V E N D O S A:

1. Fillimin e mbikëqyrjes së orientuar pranë institucioneve të administratës publike, ku përfshihet Kryeministria, të gjitha ministratë e linjës dhe institucionet e tyre të varësisë, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e pavarura, për mbledhjen e informacionit lidhur me realizimin në kohë të trajnimeve të detyrueshme dhe trajnime të tjera që synojnë rritjen profesionale të nëpunësve civilë në administratën publike.
2. Ngritjen e grupit të punës që do të mbikëqyrë këtë proces, me përbërje si më poshtë:

Arbana Basha

Drejtor i Përgjithshëm i Inspektimit dhe Mbikëqyrjes

Irma Vani

Drejtor i Çështjeve Juridike

Helga Bojaxhi Specialist në Drejtorinë e Çështjeve Juridike

Migena Haznedari Specialist në Drejtorinë e Çështjeve Juridike

Për realizimin e kësaj detyre, Grupi i Punës, brenda **10 ditëve** nga dalja e këtij vendimi, të kërkojë nga të gjitha institucionet e administratës shtetërore të përfshira në proces, informacionin e nevojshëm, të detajuar në programin e mbikëqyrjes, i cili ka lidhje me procesin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga ana e institucioneve të administratës shtetërore për periudhën nga muaji janar 2023 deri në momentin e raportimit, për rikthimin në detyrë të nëpunësve civilë gjyqfitues, si dhe të mbajë komunikim të vazhdueshëm me këto subjekte, me qëllim mbarëvajtjen e këtij procesi.

3. Për dërgimin e informacionit nga institucionet e administratës shtetërore të lihet një afat prej **60** ditësh, duke nisur nga momenti i marrjes dijeni për fillimin e mbikëqyrjes së orientuar.
4. Pas mbledhjes së informacionit paraprak grupi i punës do paraqitet në institucion për të verifikuar dokumentacionin që materializon procesin e trajnimeve për rastet kur vlerësohet e nevojshme.
5. Ky proces do të përmbyllet me një Raport Vlerësimi të hartuar nga Grupi i Punës, ku do të evidentohet situata për çdo institucion. Ky raport do të miratohet nga Komisioneri dhe do të jetë një prej dokumenteve mbi të cilin do të mbështetet edhe planifikimi i subjekteve që do të mbikëqyren gjatë vitit 2025.
6. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtoria e Çështjeve Juridike që të zbatojnë këtë vendim, duke angazhuar në mbikëqyrje anëtarët e grupit të punës, të përcaktuar në pikën 2 të tij.
7. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse që nëpërmjet specialistit të arkiv-protokollit, t’ia njoftojë këtë vendim të gjithë anëtarëve të grupit të punës, si edhe të ofrojë asistencën e nevojshme logjistike për të mundësuar realizimin e këtij procesi.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha